



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Limit Project Sh.P.K." të datës 28.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Limit Project Sh.P.K." të datës 28.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Limit Project Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 28.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

**Pretendimi nr. 1** - "Deklarata e Garancionit e datës 07 shtator 2023 përmbanë të gjitha elementet e rëndësishme të një garacioni, si aktivitetin e prokurimit, emërtimin dhe numrin e aktivitetit, autoritetin kontraktues dhe kohëzgjatjen e garancionit, dhe poashtu nuk përmbanë parakushte

*lidhur me rastet se kur garancioni nuk do të jetë i vlefshëm. Për më tepër, Deklarata e Garancionit e dorëzuar nga OE Ankues Limit Project Sh.P.K., përmbanë një referencë të qartë për momentin se kur do të fillojë të rrjedhë Garancioni, e që nënkupton se i njëjti E KA garancionin e lëshuar nga vet prodhuesi. Është tërësisht e pakuptueshme pse është kërkuar garancion nga prodhuesi. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e merr mundin që të kërkojë informata shtesë në bazë të Nenit 59, paragrafi 4 dhe Nenit 72 të Ligjit për Prokurimin, ku OE Ankues Limit Project menjëherë do të ofronte informatat shtesë lidhur me garancionin e prodhuesit ashtu siç ka kërkuar nga operatorët tjerë ofertues”.*

**Pretendimi nr. 2** – *“Lidhur me mungesën e certifikatave të sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtorët fizik Pika e dytë mbi bazën e të cilës Autoriteti Kontraktues ka eliminuar GOE i udhëhequr nga Limit Project Sh.P.K., nuk ka bazë, pasi që, në dosjen e tenderit ne kemi paraqitur listën e stafit nga kompanitë pjesmarrëse, ku sipas nenit 72 keni mundur të kërkonit sqarim nëse janë të trajnuar pjesa tjetër e stafit, ku AK, si duket nuk e ka analizuar dosjen në tërësi, pasi që, nuk mungojnë certifikatat për 11 persona, por maksimum për 4”.*

**Pretendimi nr. 3** – *“Lidhur me mos-hapjen e RAR File që përmban Planin Dinamik Autoriteti Kontraktues thekson se Plani Dinamik nuk hapet dhe për këtë kanë kërkuar interpretim nga KRPP, duke theksuar se meqë madhësia e RAR File është 1KB, nënkupton që RAR File është si zbrazet. Një pretendim dhe arsyetim i tillë për eliminimin e OE Ankues është i papabuzuar, pasi që AK, do të mjaftonte që të kërkonte sqarim sipas Nenit 72”.*

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtuesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :**

- Përmes vendimit të OSHP me nr. 2024/0001 të datës 15.04.2024, është gjetur se ju nuk jeni palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP dhe rrjedhimisht oferta juaj është eliminuar si e papërgjegjshme nga ky aktivitet i prokurimit duke u bazuar në vendimin e lartëcekur të OSHP.

Po ashtu, komisioni vlerësues pas administrimit me ofertën tuaj ka gjetur se:

1. Është kërkuar gradacioni minimum 1 vit nga prodhuesi për pozicionet sipas pikës 6, mirëpo OE e ka dorëzuar deklaratën e nënshkruar nga vet si operatorë, andaj i njëjti kusht nuk plotësohet.

2. Pika C për punëtorët fizik ku është kërkuar certifikata për siguri dhe shëndet në punë mungojnë certifikatat për 11 punëtorë.

3. Plani dinamik i kërkuar nuk hapet, për të cilin është kërkuar interpretim nga KRPP si me poshtë :

(Ne sistem te prokurimit elektronik dhe ofertën e GOE LIMITPROJECT SH.P.K.; DELTA – CCD SH.P.K.; Rinesa SH.P.K.; ILEAA - GR SH.P.K te dorëzuar ne aktivitetin e prokurimit me Nr. 616-23-7338-5-1-1 evidentohet qe oferta e shkarkuar permbane folderin e kompresuar ne formatin RAR me Nr 15 te emërtuar si Plani Dinamik.rar por me kapacitet prej 1KB qe nënkupton se është folder i zbrazet dhe nuk permbane asnjë dokument për ekstraktim (shiko PS te bashkangjitur ne këtë e-mail). Ky folder me te njëjtin emërtim, format dhe kapacitet është ngarkuar nga OE (perdoruesi "limitproject") me date 20.09.2023 dhe kohe 13:18min.

**Andaj ne baze te arsyetimeve qe u dhanë më larte AK-se konstaton se ju nuk përmbushni kërkesat e AK-se dhe për këtë aktivitet te prokurimit jeni i papërgjegjshëm.**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk është fare palë e interesuar pasi si i tillë është cilësuar sipas vendimit të OSHP me nr. 2004/0001 të datës 15.04.2024 parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme dhe duke marrë parasysh që nuk e ka kontestuar fare këtë vendim të AK, parashtruesi nuk është palë e interesuar në procesin e rivlerësimit sipas vendimit të OSHP të cituar si më sipër. Prandaj me të drejtë është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit. Megjithatë AK ka trajtuar edhe pretendimet ankimore të parashtruesi me çrast ka konstatuar si vijon:

Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 1 - në dosjen e tenderit është kërkuar dorëzimi i garancionit min 1 vit nga prodhuesi. Këtë garancion nuk e ka dorëzuar parashtruesi mirëpo në vend të saj e ka dorëzuar një deklaratë të nënshkruar nga vet parashtruesi. Këtë fakt nuk e konteston as vet parashtruesi. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor me nr. 2 dhe 3 - duhet cekur se as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit sipas arsyes me nr. 2 dhe 3 në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Parashtruesi vetëm pretendon që AK është dashur që përmes sqarimeve shtesë të lejoj parashtruesin që të dorëzoj dokumente tjera pas hapjes së ofertave. Mirëpo ky veprim do të ishte në kundërshtim me LPP pasi që do të përmbente ndryshim material të ofertës pas hapjes së tenderëve. Në anën tjetër është përgjegjësi e vet parashtruesi që të kujdeset se në ofertë janë të bashkangjitura të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas dosjes së tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka as të drejtë dhe as detyrim që të kujdeset për bashkangjitjen e dokumenteve me ofertat e operatorëve ekonomik. Sqarimet shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP mund të kërkojnë vetëm për dokumente të cilat dorëzohen nga OE mirëpo për të cilat AK mund të ketë ndonjë paqartësi apo nevojë për sqarim shtesë. Pra kërkesa për sqarime shtesë nga AK nuk mund të interpretohet si detyrim i AK për të përmisuar gabimet e OE me rastin e dorëzimit të ofertave të tyre.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 03.09.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.